



**ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA**



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e tretë të rregullt, e mbajtur më datën 24.03.2025, merr këtë:

V E N D I M Nr.11/2025/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 26.02.2025

Neni 1

Miratohet procesverbali nga mbledhja e dytë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 26.02.2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e dytë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 26.02.2025.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević

Milan Dimitrijević



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e dytë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës,

E mbajtur më datën 26.02.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi në orën 11:00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 asamblistë janë të pranishëm 15 asamblistë dhe ka kuorum, ndërsa mungojnë: Sonja Odalloviq, Dragan Maksimoviq, Nebojsa Markoviq dhe Dushan Borisavljeviq.

Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesit të KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, drejtorët e drejtorive komunale: të Buxhetit dhe Financave, të Arsimit dhe Kulturës, të Shërbimeve Publike dhe Situatave Publike, të Zhvillimit Ekonomik dhe Integritetit, pastaj Shërbimi për Përkthim, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri e ka dhënë mendimin pozitiv për rendin e ditës të propozuar.

Kryesuesi e vuri në votim rendin e propozuar të ditës:

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi rendin e mëposhtëm të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e rregullt, e mbajtur më datën 29.01.2025.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës për vitin 2024, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritetit për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritetit, Nebojsa Millovanoviq.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e rregullt, e mbajtur më datën 29.01.2025.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i buxhetit dhe financave, Sllavisha Niçiq, tha se në pjesën e parë të tabelës, e cila i referohet burimeve, shihet se kemi shpenzuar 6.395.000 euro nga grantet qeveritare, 2.921.000 euro nga të hyrat tona dhe 5.170 euro nga donacionet, që janë gjithsej 9.323.000 euro, ku janë shpenzuar: 3.987.000 euro për paga dhe mëditje; 1.964.000 euro për mallra dhe shërbime; 264.000 euro për shpenzime komunale; 663.000 euro për subvencione dhe 2.443.000 euro për investime kapitale. Tabela e dytë i referohet buxhetit fillestar i cili ishte 8.985.000 euro, ndërsa ai final 9.893.000 euro dhe realizimi i buxhetit 9.323.000 euro.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës për vitin 2024, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq, tha se edhe vitin e kaluar, si çdo vit, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Kulturës, në përputhje me planin buxhetor dhe mjetet financiare, ka investuar në projekte kapitale, shërbime komunale dhe mbështetje logjistike për të gjitha institucionet arsimore. Ajo theksoi se përkundër buxhetit të vogël për investime kapitale, i cili ishte vetëm 26.173 euro, me sukses janë realizuar tri projekte kapitale: “Ndërtimi i objektit ndihmës për vendosjen e derivateve në Qendrën e shkollave të mesme”, “Rikonstruktimi i shkollës në Livagjë” dhe “Ndërtimi i kaldajës në Gushtericën e Poshtme”. Për mallra dhe shërbime, fondi total ishte 164.489 euro, të cilat ishin të destinuara për realizimin e shërbimeve të ndryshme, si për karburant për automjete, dru zjarri për ngrohje, shërbime të internetit, blerje të pajisjeve sportive, blerje të inverterave për institucionet arsimore, kompjuterë, etj. Fondi për shpenzime komunale ishte 40.000 euro, të cilat janë shpenzuar për pagesën e shërbimeve komunale për institucionet arsimore dhe institucionet për kulturë, sport dhe rini. Në vitin 2024, Drejtoria e Arsimit ka pranuar 25 kërkesa për verifikimin e diplomave nga universitetet e Mitrovicës së Veriut, prej të cilave 12 kërkesa janë realizuar.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, e pyeti drejtoreshën a ka ndonjë problem në komunikim me shtëpitë e kulturës.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq, u përgjigj se në thelb kanë një komunikim relativisht të mirë.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, sugjeroi që të përmirësohen kushtet në oborrin e Shtëpisë së kulturës në Graçanicë.

Asamblisti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti se kur planifikohet të realizohet projekti për zgjerimin e shkollës mekanike në Preoc.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq, u përgjigj se këtë vit planifikohet zgjerimi i ankesit të Shkollës mekanike.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, propozoi që para realizimit të projektit për zgjerimin e Shkollës mekanike në Preoc, drejtorët komunalë përgjegjës për realizimin e këtij projekti të mbajnë një takim me drejtorët e shkollave. Ai shpreson që edhe renovimi i gjimnazit në Llaplasellë do të përfundojë këtë vit.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve, Nebojsa Millovanoviq.

Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve, Nebojsa Millovanoviq, tha se drejtorja përbëhet nga zyrtarët e mëposhtëm: zyrtari për projektet dhe integritime, zyrtari për regjistrimin e bizneseve, zyrtari për efikasitet energjetike, zyrtari për hartimin e projekteve dhe dokumentacionit të projekteve dhe QZHEG-ja (Qendra për Zhvillim Ekonomik Graçanica). Në vitin 2024 kemi realizuar të ardhura nga taksat në një shumë prej 4.380 euro dhe falë bashkëpunimit të mirë me partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat joqeveritare janë siguruar 79 grante dhe projekte, si dhe fuqizimi i bizneseve ekzistuese me një shumë totale prej 159,000 euro, duke përfshirë 4 grante për përkrahjen e komuniteteve dhe shoqatave në territorin e Komunës së Graçanicës me një vlerë totale prej 113.300 euro. Si një aktivitet tjetër i realizuar me sukses, Millovanoviqi e përmendi ndarjen e bursave për njëqind praktikantë përmes programit të UNHCR-së.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, i ka kërkuar drejtorit një listë me emrat e bizneseve që kanë marrë grante.

Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimeve, Nebojsa Millovanoviq, tha se listën do t’ia dërgojë në e-mail kryesuesit të Kuvendit të komunës.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti nëse zyrtari për efikasitet energjetike e ka bërë ndonjëherë testimin e ajrit në territorin e Komunës së Graçanicës.

Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Integriteteve, Nebojsa Milovanović, u përgjigj se e kanë përfunduar Strategjinë për ndotjen e ajrit, e cila duhet të jetë në rendin e ditës së Kuvendit të komunës. Strategjia është hartuar në bashkëpunim me UNDP-në dhe në atë dokument mund të shihen të dhënat zyrtare për cilësinë e ajrit në Komunën e Graçanicës, të cilat janë marrë përmes disa aparateve që janë instaluar në Graçanicë. Në strategji gjithashtu janë cekur edhe ndotësit kryesorë, njëri prej të cilëve është Shtëpia e kulturës në Graçanicë si konsumator serioz i lëndëve djegëse të ngurta (dru dhe qymyr). Në strategji gjithashtu është cekur Djerrina si ndotësit kryesorë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Të ndryshme.

Kryesuesi tha se në mbledhjen e kaluar asamblistët kanë pasur pyetje për drejtorët. Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit është lajmëruar se nuk ka mundësi të marrë pjesë në mbledhjen e sotme, ndërsa në mbledhje është i pranishëm drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Kryesuesi tha se asamblisti Ljubisha Karaxhiq pyeti nëse Komuna e Graçanicës është përgjegjëse për vendosjen e shenjave të komunikacionit në territorin e Komunës së Graçanicës.

Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Situata Emergjente, Vlladica Trajković, tha se nga Shërbimi për Çështjet e Kuvendit e ka pranuar procesverbalin nga mbledhja e kaluar e dhe se ka përgatitur përgjigje për pyetjet e parashtruara. Në kryqëzimin në Llapllasellë ka vetëm një tabelë me kalim të drejtë nga drejtimi i Preocit.

Kryesuesi tha se në mbledhjen e kaluar e ka paraqitur problemin e mungesës së shenjave të komunikacionit në rrethrotullimin në Graçanicë, ku shpesh ndodhin aksidentet.

Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Situata Emergjente, Vlladica Trajković, u përgjigj se kryqëzimi nuk është rrethrotullim, dhe se ka shenjë “Stop” për dalje në rrugën kryesore ku ndodhin aksidentet në komunikacion.

Kryesuesi tha se në mbledhjen e kaluar të Kuvendit, asamblistja Snezhana Jovanovićka kërkuar që urgjentisht të shënohet parkingu afër Qendrës së shkollave të mesme dhe sugjeroi që Drejtoria e Shërbimeve Publike të komunikojë me përfaqësuesit e Këshillave lokale për të marrë informacione prej tyre për problemet në secilin vend.

Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Situata Emergjente, Vlladica Trajković, u përgjigj se ka një bashkëpunim të mirë me përfaqësuesit e Këshillave lokale dhe se ata kanë takime kur duhet të zgjidhin ndonjë problem. Lidhur me problemin e vendeve për parking tek

Qendra e shkollave të mesme, për këto pozicione Drejtoria e Urbanizmit ka një kontratë afatgjatë.

Kryesuesi tha se asamblistja Sllagjana Rashiq vuri në dukje problemin në rrugën “Kajmakçalanska”, ku gardhi mbrojtës në njërën anë të urës ishte rrënuar.

Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Situata Emergjente, Vlladica Trajković, u përgjigj se riparimi, rehabilitimi dhe ndërtimi i rrethojave metalike për ura janë përfshirë në kontratën për asfaltimin e rrugëve dhe se ky problem do të zgjidhet në periudhën e ardhshme.

Kryesuesi tha se asamblisti Vlladica Qurçiq kërkon përgjigje në pyetjen se kur janë shpallur tenderët, kush i ka shpallur dhe pse janë vonuar tashmë një vit e gjysmë.

Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Situata Emergjente, Vlladica Trajković, u përgjigj se shefi i prokurimit më 20 qershor u ka dërguar e-mail të gjithë drejtorëve, duke theksuar se në bazë të vërejtjes së Auditimit, është dashur të anulohen kontratat për shkak të sasisë së tejkaluar. “Prej korrikut ka filluar procedura për anulimin e kontratave të vjetra, shpalljen e tenderëve dhe nënshkrimin e kontratave të reja dhe të gjitha këto janë duke u bërë nga Zyra e Prokurimit Publik. Janë nënshkruar disa kontrata, kemi ankesa për disa kontrata dhe shpresoj që kontratat e mbetura të nënshkruhen së shpejti”.

Kryesuesi pyeti a është nënshkruar kontrata për ndriçimin rrugor.

Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Situata Emergjente, Vlladica Trajković, u përgjigj se kanë përsëri një ankesë për ndriçim nga një kompani tjetër.

Kryesuesi e paraqiti problemin në një rrugë të Graçanicës (afër hekurudhës), ku rreth 5-6 shtylla me kablllo të rrymës janë të lakuar dhe ekziston rreziku i rënies së tyre.

Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Situata Emergjente, Vlladica Trajković, u përgjigj se në atë vend kishte rënë një shtyllë druri dhe përfaqësuesit e KEDS-it dërguan 4 shtylla të reja betoni që i lidhën në rrjet, por ne nuk mund ta transferojmë ndriçimin derisa të nënshkruajmë kontratën dhe pasi që në shtyllat e drurit ka edhe kablllo të internetit dhe kabllor, kam insistuar që shtyllat e vjetra të drurit të lidhen me ato të reja prej betoni për të shmangur ndonjë problem.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, pyeti se a mund të reagojë komuna në përputhje me ligjin kur ka kushte të jashtëzakonshme derisa të nënshkruhet kontrata.



Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Situata Emergjente, Vlladica Trajković, u përgjigj se në pajtim me ligjin komuna i shfrytëzon shtyllat e KEDS-it për ndriçim dhe janë të obliguar të intervenojnë. Ai dha shembullin e rënies së një peme plepi në një linjë të tensionit të

ulët në Kishnicë, ku punëtorët e komunës dhe ai pranuar kallëzim penal për ndërhyrje. Aty ku ka vetëm ndriçim në shtylla është përgjegjësia jonë.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 11:54.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milan Dimitrijević